



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KONTROLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Nr. 1133/7Prot.

Tiranë, më 23.04.2018

V E N D I M

Nr. 29, Datë 23.04.2018

PËR

**AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR SHA VLORË “MBI ZBATIMIN E
PËRPUTHSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË SË VEPRIMTARISË
EKONOMIKO-FINANCIARE”**

për periudhën nga data 01.04.2015 deri më datën 31.10.2017.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit Shoqërive Publike, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës si dhe Drejtori i Përgjithshëm, nisur nga niveli i shkeljeve dhe parregullsive të konstatuara, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr.154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

VENDOSA:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare”, të ushtruar në Portin Detar sha Vlorë, sipas programit të auditimit nr. 1133/1 prot, datë 02.11.2017, miratuar nga Kryetari i KLSH, i ndryshuar me shkresën nr. 1133/2, datë 07.01.2018, për periudhën e 01.04.2015 – 31.10.2017.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

A. OPINION I AUDITIMIT

Konkluzionet dhe baza për opinionin mbi përputhshmërinë (ISSAI 4000¹). Nga auditimi i përputhshmërinë², për sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat realizohet aktiviteti (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), në Portin Detar SHA Vlorë, gjatë auditimit janë konstatuar mospërputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator (*kriteret*), të cilat nën gjykimin profesional të audituesit shtetëror të pavarur janë materiale, por jo të përhapura duke justifikuar dhënien e *një opinionit të kualifikuar të përputhshmërisë*.

Baza për kualifikimin e Opinioneve

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI) dhe konkretisht ISSAI 4000 “Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Përputhshmërisë”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin.

Ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Ne sjellim në vëmendjen se në të gjitha procedurat e prokurimit, grupet e punës të ngritura nga titullarët e institucionit, nuk kanë analizuar dhe nuk kanë dokumentuar drejt përlogaritjen e fondit limit, duke lenë vend për devijime nga vlera reale e shërbimeve/mallrave të realizuara. U konstatua se janë vendosur kritere diskriminuese, të cilat kanë ndikuar në mospjesëmarrjen e gjerë në tenderët e hapur “Zgjerimi i terminalit të pasagjerëve të Portit Detar SHA Vlorë” dhe “Krijimi i rrjetit data të institucionit të sigurt dhe të mbrojtur nga sulmet e jashtme, telefonia VOIP dhe sistemi i komunikimit email të institucionit”, procedura që në total përbëjnë 273,596,525 lekë, vlerë që justifikon materialitetin për një opinion të kualifikuar.

B. MASA ORGANIZATIVE

¹ISSAI 4000 - 4200 - Audituesi shpreh një konkluzion me rezerve kur në gjykimin profesional të tij, efekti ose efektet e mundshme të një çështjeje, nuk janë aq materiale sa që të justifikojnë një konkluzion të kundërt ose një refuzim të konkluzionit.

²Mbeshtetur mbi ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”.

1. Gjetje nga auditimi.

Për periudhën objekt auditimi, nga subjekti janë kryer 14 procedura prokurimi me vlerë 326,126 mijë lekë dhe nga grupi i auditimit janë audituar 13 procedura prokurimi, **me vlerë 323,726 mijë lekë**, pra me një mbulim në masën 99% të vlerës së prokuruar, këtu nuk përfshihen prokurimet me vlera të vogla. Në përfundim të auditimit është konkluduar se nga subjekti nuk janë zbatuar me korrektesë të gjitha kërkesat e kuadrit rregullativ të lidhur me prokurimin publik, bazuar në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Kështu:

- Në të gjitha rastet, vlera e kontratës është llogaritur duke u mbështetur në studimin e tregut dhe sigurimin e ofertave për të njohur nivelin aktual të tregut, por nuk është dokumentuar analiza e kostos së mallrave që do të prokurohen, duke krahasuar elementet e mësipërm me specificimet teknike, në kundërshtim me neni 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

- Në tre procedura prokurimi, përkatësisht “Zgjerimi i terminalit të pasagjerëve”, “Krijimi i rrjetit data të institucionit të sigurt dhe të mbrojtur nga sulmet e jashtme, telefonia VOIP dhe sistemi i komunikimit email të institucionit” dhe “Mbikëqyrja e punimeve në objektin zgjerimi i terminalit të pasagjerëve në Portin Detar Vlorë”, vlerësimi i ofertave fituese është bazuar në vlerën më të vogël të ofertuar, në mosplotësimin e kriterëve nga të gjithë OE pjesëmarrës, në kundërshtim me nenin 66, pika 3 të VKM nr. 914 datë 29.11.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, fakt që reflekton risk operacional në realizimin me efikasitet dhe ekonomicitet të kontratave.

- Në 4 nga procedurat e prokurimit të audituara, konkretisht “Zgjerimi i terminalit të pasagjerëve”, “Krijimi i rrjetit data të institucionit të sigurt dhe të mbrojtur nga sulmet e jashtme, telefonia VOIP dhe sistemi i komunikimit email të institucionit”, “Mbikëqyrja e punimeve në objektin zgjerimi i terminalit të pasagjerëve në Portin Detar Vlorë”, me vlerë të prokuruar gjithsej 277,591,983 lekë, konstatoam se kriteret e veçanta të kualifikimit janë diskriminuese, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 e neni 20 dhe nuk përputhen me natyrën e punimeve dhe volumet e preventivit, duke orientuar procedurën drejt një operatori të paracaktuar. Sjellim një fakt, në procedurën e prokurimit “Zgjerimi i terminalit të pasagjerëve”, është kërkuar ekspert zjarrfikës në licencën e shoqërisë, 220 punëtorë, *Leje Mjedisore e tipit C, arkeolog të punësuar, etj*, të cilat nuk janë sipas volumit dhe natyrës së objektit që prokurohet;

- Nga titullari i autoritetit kontraktor nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të sanksionuara në nenin 56 të VKM nr. 914, datë 29.11.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” për sa i përket ndarjeve të detyrave të zyrtarëve/nëpunësve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe të zyrtarëve të përfshirë në vlerësimin dhe përzgjedhjen e fituesit.

- U konstatoa se nuk janë kryer trajnime të stafit për prokurimin publik, në kundërshtim me pikën 1, neni 83 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar (*trajtuar më hollësisht në faqen 35-106 të Raportit Përfundimtar*).

1.1 Rekomandimi:

-Nga Porti Detar SHA Vlorë, të eliminohen praktikat e shpalljes së ofertës më të vogël fituese në kushtet e mos plotësimit të kriterëve nga ana e operatorëve ekonomik, duke eliminuar kështu mungesën e efikasitet në shpenzimin e fondeve të shoqërisë.

- Strukturat e caktuara nga Autoriteti Kontraktor për vendosjen e kriterëve të kualifikimit, të marrin masa që të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e

operatorëve ekonomikë dhe që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre dhe të përputhen në natyrë dhe sasi me preventivat e objekteve që prokurohen.

-Titullari i AK të marrë masa për rritjen e kapaciteteve dhe trajnimin e punonjësve që do të marrin pjesë në procedurat e prokurimit.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi:

Në 6 raste, nga auditimi i kryer mbi zbatimin e punimeve civile sipas kontratave të nënshkruara: “Zgjerimi i terminalit të pasagjerëve” në Portin Detar Vlorë; “Veshje me alukobond dhe vendosje kioske në portën lindore të portit”; “Rikonstruksioni i portës hyrëse perëndimore të portit”, “Rikonstruksion i objektit të zyrave Porti Himarë”, “Rikonstruksion i reparteve dhe zyrave në oficinë”, “Linja e re e furnizimit me ujë të portit”, nga ana e Autoritetit Kontraktor nuk është aplikuar për leje ndërtimi, në kundërshtim me Ligjin Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, si dhe në kundërshtim me VKM Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” (*trajtuar më hollësisht në faqen 115-141 të Raportit Përfundimtar*).

2.1. Rekomandimi:

Nga Autoriteti Kontraktor të merren masa për pajisjen me leje ndërtimi të objekteve ndërtimore që prokurohen dhe të analizohet përgjegjësia e kryerjes së investimeve pa leje ndërtimi dhe në vazhdimësi të mos procedohet me fillimin e punimeve pa u pajisur paraprakisht me leje ndërtimi.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi në lidhje me procedurat e përgatitjes së dosjeve për dhënien me qira, u konstatua se ka mangësi në procedurën e dhënies me qira dhe në dokumentacionin e paraqitur nga subjektet e interesuara. Për miratimin e kontratave të qirasë, Shoqëria Porti Detar SHA Vlorë është mjaftuar vetëm me një kërkesë të paraqitur nga subjekti për marrjen me qira, në kundërshtim me VKM Nr. 54, datë 5.2.2014, Kapitulli II, Pika 1 dhe 7 të këtij vendimi (*trajtuar më hollësisht në faqen 147-155 të Raportit Përfundimtar*).

3.1. Rekomandimi:

Nga drejtuesit e shoqërisë, Sektori i Financave dhe Sektori Juridik të hartohen kriteret për dhënien me qira të aseteve të shoqërisë, si dhe të kualifikohen dhe pranohen ato kërkesa për marrje me qira, të cilat plotësojnë kushtet sipas legjislacionit në fuqi.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi:

Për periudhën objekt auditimi, subjekti ka kryer 3 procedura prokurimi me objekt “Blerje Karburanti”, me vlerë 7,269 mijë lekë dhe nga grupi i auditimit janë audituar të tre procedurat. Në përfundim kemi konkluduar se nga subjekti nuk ka një planifikim të drejtë të nevojave për këtë lloj malli shoqëruar me procedura formale në realizimin e procedurave të prokurimit pavarësisht efekteve financiare të munguara nga këto parregullsi. Kështu:

- NJP dhe Dega Teknike dhe e Investimeve nuk ka formuluar/nënshkruar procesverbal për hartimin e kërkesave për kualifikim dhe/ose specifikimet teknike dhe/ose kriteret e vlerësimit, specifikimet teknike, dhe grafikun e lëvrimit të karburantit në kundërshtim me neni 61 të VKM nr.914 datë 29.11.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

- Nga ana e titullarit të autoritetit kontraktor dhe NjP, në të gjitha prokurimet me objekt: “Blerje Karburantit”, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në nenin 60 të VKM nr.914, datë 29.11.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe pikën 10 të nenit 25 të Statutit të shoqërisë, për sa i përket miratimit/ përllogaritjes së fondit limit total për vitin ushtrimor.

-Dokumentet e Tenderit të hartuara nga NjP nuk përmban informacion mbi specifikimet teknike të karburantit, grafikun e lëvrimit të karburantit në kundërshtim me pikën 3/b, neni 14 të VKM nr.914 datë 29.11.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

-Në prokurimin me objekt: “Blerje Karburanti” të zhvilluara në vitin 2016, autoriteti kontraktor nuk ka analizuar shkaqet e anulimit të procedurës në të tre rastet, duke krijuar hapësira për ndryshim e llojit të procedurës së prokurimit, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 73, pika 2 (*trajtuar më hollësisht në faqen 35-106 të Raportit Përfundimtar*).

4.1 Rekomandimi:

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në procedurat e prokurimit “Blerje Karburanti”, të vlerësojë drejt kërkesat për kualifikim dhe specifikimet teknike të miratuara në dokumentet e tenderit, duke u mbështetur në dokumente zyrtare dhe fletë analiza të lëshuara nga organet kompetente.

- Anulimi i procedurave të prokurimit nga autoriteti kontraktor, të kryhet duke analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë për arsyet e procedurave të anuluar, të cilat duhet të jenë mjaftueshmërisht bindëse dhe duhet t’u komunikohen të gjithë pjesëmarrësve në procedurën e prokurimit.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi:

Në të gjitha rastet titullari i autoritetit kontraktor nuk ka urdhëruar ngritjen e komisionit për monitorimin e zbatimit të kontratave. Nuk ka raporte mbi monitorimin e zbatimit të kontratës sipas specifikimeve teknike, sasitë, shërbimet e kryera etj., në kundërshtim me VKM nr. 914, 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, kreu IX, “Ekzekutimi dhe mbikëqyrja e kontratës” neni 77. Gjithashtu, në përfundim të kontratës, autoriteti kontraktor nuk ka përgatitur një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu IX neni 77, pika 1 (*trajtuar më hollësisht në faqen 115-141 të Raportit Përfundimtar*).

5.1 Rekomandimi:

Titullari i AK të marrë masa që për të gjitha kontratat e zbatimit të ngrejë komisionin e monitorimit të zbatimit të kontratave, në mënyrë që ecuria e punimeve të jetë konform kushteve të kontratës, duke bërë njëherazi edhe kontrollin e zbatimit të grafikut dhe cilësisë së punimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi

-Në lidhje me kryerjen e inventarizimit të aktiveve që kryhet çdo fundviti, për periudhën objekt auditimi në shoqërinë Porti Detar SHA Vlorë, nuk është caktuar nëpunësi zbatues si kryetar i komisionit, si dhe në komisionin e nxjerrjes së aktiveve jashtë përdorimit janë caktuar 3 persona dhe jo 5, duke vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.11.2011, “Për menaxhimin e aktiveve

në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pikat 99 dhe 100 (*trajtuar më hollësisht në faqen 144-146 të Raportit Përfundimtar*).

--Në lidhje me Procesverbalet e mbajtura për materialet të cilat do të nxirren jashtë përdorimit konstatohet se janë pa nr. protokollit dhe pa datë.

Gjithashtu, në të gjitha rastet e procedurave të blerjeve me vlera të vogla konstatohet se, kërkesat për mallra dhe shërbime janë pa numër protokollit dhe pa datë, veprime të cilat janë në kundërshtim me kundërshtim me Ligjin nr.9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”, Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.11.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pika 36 “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve” (*trajtuar më hollësisht në faqen 30-34 të Raportit Përfundimtar*).

6.1. Rekomandimi:

-Drejtoria e Porti Detar sha. Vlorë, të marrë masat e duhura për të ardhmen, që në proceset e vlerësimit të aktiveve dhe inventarizimit të shoqërisë, të procedohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

-Nga Porti Detar Vlorë të merren masat për periudhën në vazhdim që dokumentet zyrtare të cilat janë të rëndësishme për gjurmën e auditit, por edhe për kronologjinë e kryerjes së veprimtarisë së kësaj shoqërie, për të qenë dokumentacioni i rregullt, të operohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për regjistrimin në librat protokollarë.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi

Për periudhën objekt auditimi në lidhje me procesin e inventarizimit u konstatua se nuk janë hartuar regjistrat kontabël të përditësuar të shoqërisë, duke vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pikat 26-33 (*trajtuar më hollësisht në faqen 30-34 të Raportit Përfundimtar*).

7.1. Rekomandimi:

Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtoria e Porti Detar sha Vlorë, të marrin masa, nëpërmjet strukturave përgjegjëse të shoqërisë, për të bërë të mundur sa më parë hartimin e regjistrave kontabël të aktiveve, të cilat të jenë sipas formatit të kërkuar dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion mbi veprimtarinë e Këshillit Mbikëqyrës, u konstatua se:

-Mënyra e thirrjes së mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës është kryer jo në përputhje me Udhëzimin nr. 318, datë 08.04.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, kreu II, pika 6/a.

-Nuk është miratuar programi vjetor i veprimtarisë së Këshillit Mbikëqyrës, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 318, datë 8.4.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e këshillit mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, kreu III, pika 1.

-Në dokumentacionin e vënë në dispozicion, nuk gjenden CV e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 318, datë 8.4.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e këshillit mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, kreu II, pika 2.

- Nuk konstatohen deklaramet me shkrim në drejtorinë e shoqërisë për shpërblimin për pjesëmarrje në këshillin e parë apo të dytë për asnjë nga anëtarët apo ish-anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 318, datë 8.4.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e këshillit mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, kreu V, pika 2.

-Në dy raste, Këshilli Mbikëqyrës me vendime të ndryshme ka miratuar nivelin e pagave, por pa marrë më parë miratimin e Ministrit, në kundërshtim me Ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 6, pika 1, germa a.

-Në dy raste, Këshilli Mbikëqyrës me vendime të ndryshme ka vendosur miratimin e dhënies së shpërblimit vjetor me një pagë mujore për punonjësit e shoqërisë, por pa marrë më parë miratimin e Ministrit, në kundërshtim me Ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 6, pika 1, germa b (*trajtuar më hollësisht në faqen 17-22 të Raportit Përfundimtar*).

8.1 Rekomandimi:

Këshilli Mbikëqyrës gjatë veprimtarisë së tij të shmangë praktikën e evidentuara me mangësi, duke miratuar programin vjetor të veprimtarisë së tij, duke miratuar nivelin e pagave dhe shpërblimeve me miratimin e Ministrit të Linjës, si dhe duke bërë plotësimin e dosjeve personale për të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës.

Në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi;

Në lidhje me detyrimet që duhet të derdhen nga shoqëria për llogari të ish-të dënuarve politikë dhe ish-të përndjekurve politikë, në shumën prej 1% të fondit vjetor të pagave, u konstatua se për periudhën objekt auditimi nuk është kryer asnjë pagesë, e cila përgjatë 3 viteve 2015, 2016 dhe 2017 shuma që duhet të paguhej është 2,024,340 lekë, duke vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 7598, datë 01/09/1992 “Për krijimin e fondit të veçantë monetar për ish-të përndjekurit politikë”, neni 1, pika b), apo VKM nr. 392, datë 12.08.1999 “Për administrimin e fondit të veçantë monetar” (*trajtuar më hollësisht në faqen 17-22 të Raportit Përfundimtar*).

9.1 Rekomandimi:

Nga ana e Shoqërisë të merren masat e duhura për përmbushjen e detyrimeve ligjore për derdhjen e kontributeve të detyrueshme për ish të përndjekurit dhe ish të dënuarit politikë, për kryerjen e pagesës brenda afateve të përcaktuara dhe në përputhje me vlerën e përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi si dhe të hartohet dhe zbatohet një grafik për shumën e pa paguar prej 2,024,340 lekë .

Deri më datën 31.10.2018

10. Gjetje nga auditimi

Nga shoqëria Porti Detar SHA Vlorë nuk është zbatuar Ligji për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin si dhe nuk është implementuar në Rregulloren e Brendshme të Shoqërisë. Ligji nuk njihet nga strukturat drejtuese të shoqërisë e punonjësit e saj dhe për pasojë nuk ka funksionuar në asnjë hallkë të njësisë ku drejtuesit nuk kanë bërë një vlerësim të efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Nga shoqëria nuk janë përcaktuar procedura të brendshme të anti korrupsionit dhe të sinjalizimit të parregullsive, nuk është hartuar dhe dërguar në Ministri deklarata dhe raporti vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm. Për vitet 2015- 2017 shoqëria Porti Detar SHA Vlorë, nuk ka plotësuar dhe dërguar në Ministri pyetësorin e vetëvlerësimit për komponentët e MFK-së, nuk ka hartuar dhe miratuar planin i cili përmban objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit. Gjithashtu njësisia nuk ka një

Kod të Brendshëm Etik ose një Kod Sjellje, rregullore apo, udhëzim për zbatimin e etikës, si dhe nuk ka procedurë për të raportuar shkeljet e legjislacionit mbi etikën dhe për marrjen e masave për shkeljet e konstatuara. Nuk ka rregulla të brendshme të miratuara nga titullari, për kryerjen e shpenzimeve dhe funksioneve të ndryshme të shoqërisë si dhe rregulla për delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre, nuk ka hartuar strategjinë e riskut dhe regjistrin e riskut, e për pasojë drejtuesit, nuk kanë dijeni për përgjegjësinë që kanë në menaxhimin e riskut, edhe pse mangësitë në implementimin e MFK janë të identifikuara edhe në auditimin e mëparshëm të KLSH, konstatohet se nga shoqëria nuk ka asnjë reagim (*trajtuar më hollësisht në faqen 17-22 të Raportit Përfundimtar*).

10.1 Rekomandimi:

Nga Këshilli Mbikëqyrës të merren masat e menjëhershme në drejtim të implementimit në rregulloren e Brendshme të Shoqërisë, të Ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, të miratohen rregullat e funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm si dhe vënien e administratorit të shoqërisë dhe drejtuesve të tjerë kundrejt përgjegjësisë dhe detyrimit të marrjes së masave për implementimin e ligjit dhe njëkohësisht ndërjegjësimin e të gjithë punonjësve për zbatimin e kërkesave të ligjit për MFK, sa më sipër cituam dhe akteve të dala në funksion të tij. Nga Titullari i shoqërisë të merren masa për trajnimin e të gjithë stafit të shoqërisë në lidhje me kërkesat e MFK dhe vënien në efikasitet të sistemit të kontrollit të brendshëm.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi;

Në lidhje me kryerjen e procedurave të blerjeve me vlera të vogla konstatohet se është caktuar në komisionin e blerjeve me vlera të vogla përgjegjësjë e financës, duke vepruar në kundërshtim me *ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 2, pika 5, me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 52, dhe me Rregulloren e Brendshme të Porti Detar Vlorë SHA, miratuar me vendimin nr. 6, datë 25.03.2016 të Këshillit Mbikëqyrës, Kapitulli V, Zyra e Administrimit Financiar, paragrafi i parë.*

Konstatohet se në të gjitha rastet e blerjeve me vlera të vogla nuk dokumentohet mënyra e llogaritjes së fondit limit, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, kreu VII, neni 59.

-Në 5 procedura prokurimi me vlerë të vogël është copëzuar fondi, duke shmangur kryerjen e procedurave normale të prokurimit nëpërmjet procesit të procedurave të tenderimit, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, kreu IV, neni 40, pikat 1 dhe 8, Udhëzimin nr. 1, datë 21.04.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr. 3, datë 27.01.2015 “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël”.

-Janë kryer 3 procedura prokurimi me vlerë të vogël nën vlerën 100,000 lekë në mënyrë shkresore, por shuma e të 3-jave shkon në vlerën 223,782 lekë, procedura të cilat duhet të kryheshin në mënyrë elektronike, pasi qëllimi i tyre është i njëjtë dhe për të njëjtin grup mallrash, pra është vepruar në kundërshtim me Udhëzimin Nr. 2, datë 24.04.2017, “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël”.

-Në dy procedura prokurimi janë vendosur kritere për përmbushjen e detyrimeve nga Operatorët Ekonomik pjesëmarrës, por këto dokumente nuk janë kërkuar për tu paraqitur pasi është shpallur OE fitues, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, Kreu V, neni 55, pika 2, me Udhëzimin nr. 1, datë 21.04.2016 “Për disa shtesa dhe

ndryshime në Udhëzimin Nr. 3, datë 27.01.2015 “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël”, pika 3, paragrafi i dytë (*trajtuar më hollësisht në faqen 17-22 të Raportit Përfundimtar*).

11.1 Rekomandimi:

Nga ana e drejtuesve të Shoqërisë të merren masa që në komisionet e ngritura për blerjet e vogla të mos caktohet Përgjegjësja e Financës dhe të veprohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në lidhje me kryerjen e procedurave të blerjeve me vlera të vogla, të merren masat për të mos përsëritur shkeljet e konstatuara në gjetjen sa më sipër, duke vepruar në përputhje me legjislacionin në fuqi për Prokurimin Publik, si dhe aktet e dala në funksion të tij.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi;

Janë kryer pagesa nëpërmjet bankës për kontrata furnizimi me karburant në **16 raste** pa kërkuar deklaratën doganore SAD të OE kontraktues, mbi bazën e të cilit do të llogaritej çmimi për njësi i karburantit, por çmimi është vendosur bazuar në faturën me TVSH sipas furnizimit të shoqërisë, dhe buletinit të fundit sipas datës së faturës dhe kursit të këmbimit, veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 914 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu IX, neni 77, pika 5 dhe 6 (*trajtuar më hollësisht në faqen 17-22 të Raportit Përfundimtar*).

12.1 Rekomandimi:

Të merren masat e duhura për kontratat e furnizimit me karburant që do të lidhen në vazhdim, që në hartimin e tyre të kërkohet nga OE fitues paraqitja e Deklaratës Doganore SAD në momentin e furnizimit dhe fletë analiza e karburantit, për përmbushjen e detyrimeve dhe llogaritjen e saktë të vlerës së faturës, gjithashtu nga komisioni i marrjes në dorëzim dhe nënshkruesi i urdhërshpenzimit të kërkohet për çdo faturë ky dokument në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi;

Në lidhje me mbajtjen dhe dokumentimin e shpenzimeve të automjeteve, konsumit të karburantit, shpenzimeve për goma, bateri, servise etj., rezultoi se nga Dega Teknike, nuk janë plotësuar kartelat përkatëse për çdo mjet, ku të jenë të evidentuara të dhënat teknike të mjetit, defektet e konstatuara, shërbimet e kryera periodike etj. Gjithashtu për automjetet nuk është evidentuar kilometrazhi i tij në fillim të vitit dhe në fund të vitit për të bërë ndjekjen e shpenzimeve periodike për goma, filtra e vaj, karburant, riparime etj., shpenzime të cilat nuk mund të përlllogariten pa pasqyruar elementin bazë i cili është kilometrazhi, për ndjekjen e shpenzimeve për mirëmbajtje dhe shfrytëzimin e tyre, si dhe për gjurmën standarde të auditimit, veprime të cilat janë në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2012, “Menaxhimi i aktiveve të njësitë e sektorit publik”, pikat 19, 26, 35, 121, 122, Rregulloren e brendshme të shoqërisë miratuar me vendimin nr. 07, datë 04.04.2017 të KM, kapitulli VIII (*trajtuar më hollësisht në faqen 17-22 të Raportit Përfundimtar*).

13.1 Rekomandimi:

Nga ana e Drejtuesve të Shoqërisë dhe strukturave mbështetëse në funksion të saj, për të shmangur shkeljet e konstatuara në këtë material auditimi, të merren masat për kontrolle të vazhdueshme në lidhje me mbajtjen e dokumentacionit të duhur për shpenzimet e kryera për automjetet, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimit;

Në lidhje me procedurën e prokurimit “Blerje pajisje informatike për Portin e Himarës”, u konstatua se nga zbatimi i kësaj kontrate, mungonte 240 ml kabëll në vlerën 48,960 lekë, pra nuk ekzistonte fizikisht.

Nga ana e drejtuesit të shoqërisë nuk janë marrë masat e duhura për ngritjen e një komisioni për mbikëqyrjen e kontratës duke vepruar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, kreu IV, neni 77, pikat 3 (*trajtuar më hollësisht në faqen 17-22 të Raportit Përfundimtar*).

14.1 Rekomandimi:

Nga ana e drejtorisë së shoqërisë të analizohet me grup pune të veçantë, shkaqet dhe përgjegjësitë për këtë konstatim dhe mungesës së kabullit; të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për verifikimin e materialit të munguar, dhe në të kundërt të kërkohet dëmshpërbim nga personat përgjegjës për arkëtimin e shumës 48,960 lekë.

Menjëherë

15. Gjetje nga auditimi

Nga verifikimi i librit të masave dhe situacionit progresiv Nr. 3 të objektit “Zgjerimi i terminalit të pasagjerëve në Portin Detar Vlorë”, rezultoi se është certifikuar nga ana e kontraktorit dhe miratuar nga mbikëqyrësi i punimeve dhe titullari i Autoritetit Kontraktor, zëri i punimeve “Konstruksione metalike të përbëra”, në sasinë 115.7 ton x 310,000 lekë/ton = 35,867,000 lekë. Pas verifikimit të punimeve në objekt, u konstatua se materialet (profilet metalikë) janë në kantierin e objektit, por deri në kohën e kryerjes së auditimit, ky zë pune nuk është realizuar në vepër. Për sa sipër, vlera prej 35,867,000 lekë, është certifikuar në kundërshtim me pikën 17 të Udhëzimit të KM Nr.3 datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve”, i ndryshuar dhe pikën 8, kreu II “Zbatimi i punimeve të ndërtimit”, të UKM nr. 2, datë 13.05.2005, “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, sipas të cilës “Punimet e përfunduara dhe të marra në dorëzim në kantier, paraqiten nga sipërmarrësi në situacionet pjesore, sipas periudhave progresive të zhvillimit të punimeve, dhe në atë përfundimtar”. Nga dokumentacioni shtesë bashkëlidhur observacionit të sjellë për Projektraportin, rezulton se ky zë pune tashmë është i përfunduar (*trajtuar më hollësisht në faqen 120-126 të Raportit Përfundimtar*).

15.1 Rekomandim

Titullari i AK të marrë masa që për kontratën “Zgjerimi i terminalit të pasagjerëve”, si një objekt shumë i rëndësishëm për peshën që zë në shpenzimet e shoqërisë dhe në shfrytëzimin e tij në të ardhmen, të ngrejë një komision për monitorimin e kontratës, i cili të pasqyrojë gjendjen faktike të realizimit të kontratës dhe grafikut të punimeve, para certifikimit të punimeve të realizuara.

Menjëherë

16. Gjetje nga auditimi

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të dhëna në auditimet e mëparshme, konstatohet se disa nga rekomandimet e dhëna nga KLSH, janë kundërshtuar në gjykatë nga personat e ngarkuar me përgjegjësi dhe janë marrë vendime gjyqësore pa qenë palë KLSH, si institucioni që ka dhënë rekomandimet.

16.1 Rekomandim.

Porti detar SHA Vlorë të njoftojë Kontrollin e Lartë të Shtetit, në të gjitha rastet që zbatimi i rekomandimeve kalon në proces gjyqësor, me qëllim që KLSH të jetë e pranishme, si palë që ka njohuri për çështjen.

17. Gjetje nga auditimi

Nga auditimi i masave të marra për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, ka rezultuar se ana e KLSH-së, me shkresën nr. 1073/35, datë 29.01.2016, janë dërguar rekomandimet për masat e pazbatuara nga ana e Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë dhe gjendja e zbatimit të tyre për katër rekomandime është si më poshtë:

Rekomandimi 1. *Këshilli Mbikëqyrës, të marrë në analizë si dhe të evidentojë përgjegjësitë konkrete për efektin financiar negativ në vlerën 2,500,964 lekë, të shkaktuar nga ndërprerja e marrëdhënieve administrative të punës për 23 punonjës të shoqërisë.*

Nuk është bërë asnjë analizë nga Këshilli mbikëqyrës përse rekomandohet nga KLSH për përgjegjësitë konkrete që kanë shkaktuar efektin negativ financiar prej 2,500,964 lekë.

Ky rekomandim është i pazbatuar.

Rekomandimi 2. *Këshilli Mbikëqyrës, të analizojë dhe të evidentojë përgjegjësitë konkrete për efektin financiar negativ të shkaktuar nga largimet e padrejta nga puna të punonjësve në vlerën 5,359,162 lekë.*

Nuk është bërë asnjë analizë nga Këshilli Mbikëqyrës përse rekomandohet nga KLSH për përgjegjësitë konkrete që kanë shkaktuar efektin negativ financiar prej 5,359,162 lekë.

Ky rekomandim është i pazbatuar.

Rekomandimi 3. *"Këshilli Mbikëqyrës të marrë në analizë si dhe të evidentojë përgjegjësitë konkrete për efektin financiar negativ në vlerën 550,894 leke, të shkaktuar si investim jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficientës dhe efektivitetit, si dhe jashtë objektit të prokurimit "Rehabilitim i murit rrethues dhe godinave të Portit Detar Vlorë"*

Këshilli Mbikëqyrës në mbledhjen e datës 17.02.2016, nuk e ka shqyrtuar problemin e përgjegjësisë konkrete për mangësinë e gjetura nga KLSH mbi efektin negativ financiar në vlerën 550,894 leke.

Ky rekomandim nuk është i zbatuar

Rekomandimi 4. *"Këshilli Mbikëqyrës të marrë në analizë si dhe të evidentojë përgjegjësitë konkrete për shpenzimin e kryer në vlerën 3,817,920 lekë, me objekt "Blerje makineri-pajisje për kabinat elektrike 20kV TIP me bokse të Portit Detar Vlorë", shpenzim jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficientës dhe efektivitetit, për arsye se nuk është argumentuar teknikisht nevoja e kryerjes së kësaj procedure"*

Këshilli Mbikëqyrës në mbledhjen e datës 17.02.2016, nuk e ka shqyrtuar problemin e përgjegjësisë konkrete për mangësinë e gjetura nga KLSH mbi efektin negativ financiar në vlerën 3,817,920 leke.

Ky rekomandim nuk është i zbatuar

17. Rekomandimi

Këshilli mbikëqyrës i shoqërisë Porti Detar SHA Vlorë, të marrë masa të menjëhershme për shqyrtimin e rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në auditimin paraardhës dhe të përcaktojë përgjegjësitë për mangësitë e konstatuara dhe afatet kohore për zbatimin e këtyre rekomandimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

B.1 MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Nga auditimi i zbatimit të punimeve të kryera gjatë periudhës së auditimit, u konstatua dëm ekonomik i arkëtueshëm në vlerën 1,896,176 lekë, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi:

Në zbatimin e punimeve të kontratës me nr.462, datë 29.10.2015, me objekt : *“Rikonstruksion i objektit të zyrave Porti Himarë”*, me vlerë ekonomike 3,322,519.20 lekë me tvsh, afat i realizimit të kontratës ka qenë 60 ditë dhe kontrata shtesë nr.562/1 prot., datë 03.12.2015 me vlerë ekonomike 624,612. Janë përfituar nga sipërmarrësi më tepër, për volume punimesh të pakryera, përlllogaritur në situacionet e punimeve dhe paligjshmërinë e lidhjes së shtesës së kontratës duke shkaktuar **dëm ekonomik në shumën 525,972 lekë (me t.v.sh)** (trajtuar më hollësisht në faqen 120-141 të Raportit Përfundimtar).

1.1 Rekomandimi:

-Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **525,972 lekë me tvsh**, nga operatori ekonomik “E. & C.” shpk, për shkeljet dhe volumin e punimeve konstatuara në zbatimin e kontratës dhe shtesës së kontratës në objektin :*“Rikonstruksioni i objektit të zyrave Porti Himarë”*.

Brenda datës 31.05.2018

2. Gjetje nga auditimi

Në zbatimin e punimeve të kontratës me nr. 414, datë 04.09.2015, me objekt: *“Rikonstruksion i reparteve dhe zyrave në ofiçinë”*, në shumën 5,471,892 lekë me tvsh, afat i realizimit të kontratës ka qenë 60 ditë. Janë përfituar nga sipërmarrësi më tepër, për volume punimesh të pakryera, përlllogaritur në situacionet e punimeve duke shkaktuar **dëm ekonomik në shumën 772,635 lekë (me tvsh)** (trajtuar më hollësisht në faqen 120-141 të Raportit Përfundimtar).

2.1 Rekomandimi:

-Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **772,635 lekë me tvsh**, nga operatori ekonomik “Sh.” shpk, për shkeljet dhe volumin e punimeve konstatuara në zbatimin e kontratës dhe shtesës së kontratës në objektin: *“Rikonstruksioni i reparteve dhe zyrave në ofiçinë”*.

Brenda datës 31.05.2018

3. Gjetje nga auditimi:

Në zbatimin e punimeve të kontratës me nr.540 prot, datë 15.09.2015, me objekt: *“Rikonstruksion i portës hyrëse perëndimore të portit”*, me vlerë ekonomike 10,329,600 lekë me tvsh, afat i realizimit të kontratës është 40 ditë. Janë përfituar nga sipërmarrësi më tepër, për volume punimesh të pakryera, përlllogaritur në situacionet e punimeve duke shkaktuar **dëm ekonomik në shumën 180,777 lekë (me tvsh)** (trajtuar më hollësisht në faqen 120-141 të Raportit Përfundimtar).

3.1 Rekomandimi:

-Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **180,777 lekë me tvsh**, nga operatori ekonomik “S.” shpk, për volumin e punimeve të pakryera konstatuara në zbatimin e kontratës me objekti:*“Rikonstruksioni i portës hyrëse perëndimore të portit”*.

Brenda datës 31.05.2018

4. Gjetje nga auditimi

Në zbatimin e punimeve të kontratës me nr.329 pot, datë 16.07.2015, me objekt : “Linja e re e furnizimit me ujë të portit”, me vlerë ekonomike 5,916,726 lekë me tvsh, afat i realizimit të kontratës është 60 ditë. Janë përfituar nga sipërmarrësi më tepër, për volume punimesh të pakryera dhe përllëgaritur në situacionet e punimeve duke shkaktuar **dëm ekonomik në shumën 314,552 lekë (me tvsh)** (trajtuar më hollësisht në faqen 120-141 të Raportit Përfundimtar).

4.1 Rekomandimi:

-Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 314,552 lekë me tvsh, nga operatori ekonomik “Sh.” SHPK, për shkeljet dhe volumin e punimeve konstatuara në zbatimin e kontratës dhe shtesës së kontratës në objektin “Linja e re e furnizimit me ujë të portit”.

Brenda datës 31.05.2018

5. Gjetje nga auditimi

Nga auditimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e zbatimit të kontratës “Veshje me alukobond dhe vendosje kioske në portën lindore të portit”, u konstatua në zërin veshje me alukobond, kolonat (trung koni) diferenca e volumit e përfituar më tepër është 11.36 m². Për pasojë operatori ekonomik “S.” SHPK ka përfituar më tepër vlerën 85,200 lekë (11.36 m² x 7500 lekë/m²) pa tvsh, për punime të pakryera, në kundërshtim me pikën 17 të Udhëzimit të KM Nr.3 datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve”, i ndryshuar. **Shuma prej 102,240 lekë është dëm ekonomik** për buxhetin e shoqërisë (trajtuar më hollësisht në faqen 120-141 të Raportit Përfundimtar).

5.1 Rekomandim

- Porti Detar SHA Vlorë të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **102,240 lekë me tvsh**, nga operatori ekonomik “S.” shpk, për shkeljet dhe volumin e punimeve të përfituara më tepër, të konstatuara në auditimin e zbatimit të kontratës në objektin “Veshje me alukobond dhe vendosje kioske në portën lindore të portit”.

Brenda datës 31.05.2018

6. Gjetje nga auditimi:

Nga verifikimi i dokumentacionit të zbatimit të punimeve në objektin “Krijimi i rrjetit data të institucionit të sigurt dhe të mbrojtur nga sulmet e jashtme, telefonia VOIP dhe sistemi i komunikimit email të institucionit”, rezulton se zbatimi i punimeve duhet të kishte filluar në datën 28.08.2017 dhe të përfundonte në datën 27.11.2017. Me shkresën e protokolluar në Porti Detar sha Vlorë me nr. 879 prot., datë 06.12.2017, ose 8 ditë pas përfundimit të kontratës, është kërkuar nga nënkontraktori “V.” SHPK shtyrje e afatit të përfundimit të punimeve për shkak të forcave madhore, (përmbytje e zyrave) deri në datën 29.12.2017, kërkesë kjo e miratuar nga AK me shkresën nr. 879/2, datë 06.12.2017. Miratimi i kësaj kërkesë është në kundërshtim me kushtet e kontratës, pasi kërkesa për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve është bërë pas afatit kontraktual të përfundimit të punimeve dhe nuk ka patur forcë madhore që të justifikojë afatin e shtyrjes së punimeve me 30 ditë. Nga llogaritjet e bëra për penaltetet, në rast të mosaprovimit të shtyrjes së kontratës, do të kishim 0.004 x 9,000,000 lekë x 30 ditë = 1,080,000 lekë penaltete (trajtuar më hollësisht në faqen 129-133 të Raportit Përfundimtar).

6.1 Rekomandimi:

Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë të shqyrtojë vlerën **1,080,000 lekë**, vlerë e cila ka të bëjë me mungesën e penaliteteve për mosdorëzimin në kohë të shërbimit, si dhe të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, për arsye se kjo vlerë përbën dëm ekonomik për Shoqërinë “Porti Detar” SHA Vlorë.

Brenda datës 31.05.2018

B 1/2. DËM EKONOMIK PA MUNDËSI ARKËTIMI

Nga auditimi i zbatimit të ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese gjatë periudhës së auditimit, u konstatua dëm ekonomik i paarkëtueshëm në vlerën 6,089,251 lekë, si më poshtë:

1 Gjetje nga auditimi:

1. Me Vendimin nr. 16, datë 26.06.2015, Këshilli Mbikëqyrës ka vendosur: “...*me propozim të Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes; Vendosi: 1. Lirimin e z. Xh.Ç., nga detyra e Administratorit të Shoqërisë “Porti Detar” SHA Vlorë. 2. Marrëdhëniet financiare rregullohen sipas legjislacionit në fuqi.*”. Në ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me ish Administratorin e shoqërisë, nga Këshilli Mbikëqyrës nuk janë ndjekur hapat ligjore në zbatim të Kodit të Punës, si dhe në kundërshtim me nenin 5 të kontratës nr. 44, datë 26.01.2015 “Për administrimin dhe drejtimin e shoqërisë”. z. Xh. Ç. e ka ndjekur në rrugë ligjore lirimin e tij nga detyra, dhe me Vendimin e Gjykatës së Apelit nr. 332, datë 15.03.2017, është vendosur dëmshpërblimi i tij me 15 paga, ose në vlerën 1,920,032 lekë. Nga kjo vlerë, vlera 1,815,075 lekë përbën detyrimin për pagë, vlera 53,748 lekë përbën detyrime përmbartimore dhe vlera 51,200 lekë përbën shpenzime gjyqësore.

Për sa më sipër, nga vendimmarrja në kundërshtim me Kodin e Punës, Këshilli Mbikëqyrës i ka shkaktuar buxhetit të shoqërisë Porti Detar SHA Vlorë, **dëm ekonomik në vlerën 1,920,032 lekë.**

2. Me Vendimin nr. 30, datë 31.10.2016, Këshilli Mbikëqyrës ka vendosur: “...*pasi analizoi ecurinë e shoqërisë gjatë vitit 2016, duke synuar rritjen e mëtejshme të performancës së saj; Vendosi: 1. Lirimin e z. T. N., nga detyra e Administratorit të Shoqërisë “Porti Detar” SHA Vlorë. 2. Dorëzimi i detyrës dhe ndërprerja e marrëdhënieve financiare të bëhet konform legjislacionit në fuqi.*”. Në ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me ish Administratorin e shoqërisë, nga Këshilli Mbikëqyrës nuk janë ndjekur hapat ligjore në zbatim të Kodit të Punës, si dhe në kundërshtim me nenin 5 të kontratës nr. 452, datë 27.07.2016 “Për administrimin dhe drejtimin e shoqërisë”. z. T. N. e ka ndjekur në rrugë ligjore lirimin e tij nga detyra, dhe me Vendimin e Gjykatës së Apelit nr. 672, datë 23.05.2017, është vendosur dëmshpërblimi i tij me 13 paga e 9 ditë, ose në vlerën 1,870,124 lekë.

Për sa më sipër, nga vendimmarrja në kundërshtim me Kodin e Punës, Këshilli Mbikëqyrës i ka shkaktuar buxhetit të shoqërisë Porti Detar SHA Vlorë, **dëm ekonomik në vlerën 1,870,124 lekë.**

3. Me Vendimin nr. 11, datë 21.07.2017, Këshilli Mbikëqyrës ka vendosur: “...*me qëllim rritjen e mëtejshme të performancës së veprimtarisë së shoqërisë; Vendosi: 1. Lirimin e znj. J.H., nga detyra e zv. drejtorit të Shoqërisë “Porti Detar” SHA Vlorë. 2. Dorëzimi i detyrës dhe ndërprerja e marrëdhënieve financiare të bëhet konform legjislacionit në fuqi.*”. Në ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me ish zv. drejtoreshën e shoqërisë, nga Këshilli Mbikëqyrës nuk janë

ndjekur hapat ligjore në zbatim të Kodit të Punës, si dhe në kundërshtim me nenin 5 të kontratës nr. 453, datë 27.07.2016 “Për administrimin dhe drejtimin e shoqërisë”. znj. J. H. e ka ndjekur në rrugë ligjore lirim të saj nga detyra, dhe Gjykata e Shkallës së Parë ka vendosur dëmshpërblimin me 19 paga. Çështja është ankimuar në Gjykatën e Apelit e po pret të gjykimin. Për sa më sipër, nga vendimmarrja në kundërshtim me Kodin e Punës, Këshilli Mbikëqyrës deri në përfundim të Vendimit të Gjykatës së Apelit, mund të shkaktojë buxhetit të shoqërisë Porti Detar SHA Vlorë, dëm ekonomik pa mundësi arkëtimi në masën e 19 pagave, ose 2,299,095 lekë (trajtuar më hollësisht në faqen 17-22 të Raportit Përfundimtar).

1.1 Rekomandimi:

Nga Këshilli Mbikëqyrës të eliminohen praktikatat e largimeve nga puna në mospërputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim shmangien e detyrimeve të shtuara ndaj të tretëve, të cilat vetëm në tre rastet e shqyrtuara për periudhën e auditimit janë në **vlerën 6,089,251 lekë**, e cila është dëm ekonomik pa mundësi arkëtimi për shoqërinë, si dhe në të ardhmen të merren masa për ndjekjen me përgjegjësi të procedurave gjyqësore për dëmshpërblimet që mund të vijnë si rezultat i zgjidhjes së kontratës së punësimit.

Brenda datës 31.05.2018

B.2. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICIENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për procedurat e prokurimit, të për dhënien me qera të ambienteve dhe pagave, u konstatua efekte ekonomike financiare në vlerën 3,672,802 lekë, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi:

Në procedurën e prokurimit me objekt “Hartimi i projekt-preventiv të zbatimit për zgjerimin e terminalit të pasagjerëve në Portin Detar SHA Vlorë” përlllogaritja e fondit limit është bërë sipas VKM nr. 704, datë 29.10.2014 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, i ndryshuar, duke marrë për bazë një projekt preventiv paraprak të realizuar në Degën Teknike të shoqërisë në vlerën e objektit 215,609,846 lekë.

Në procesverbalin e përlllogaritjes së fondit limit është bërë llogaritja e tarifave të projektimit për arkitektin në vlerën 6,621,076 lekë, nisur nga kostoja totale e llogaritshme në vlerë 215,609,846 lekë. Kësaj vlerë i janë shtuar tarifat e projektimit për inxhinierin konstruktor në vlerën 1,643,826 lekë, të projektimit për inxhinierin elektrik në vlerë 164,477 lekë, të projektimit për inxhinierin hidroteknik në vlerë 72,299 lekë dhe të projektimit të kondicionim aspirimit në vlerë 893,798 lekë, duke bërë vlerën totale të projektimit 9,395,476 lekë. Vlera totale e llogaritur në këtë mënyrë është në kundërshtim me VKM nr. 704, datë 29.10.2014 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, i ndryshuar, sipas të cilës tarifat e projektimit për sistemet teknike llogariten nëse kërkohen veçmas apo nëse shuma e preventivuar e sistemeve teknike është më e madhe se 15% e kostonë llogaritshme (shtojca 12). Diferenca prej **2,021,792 lekë** (9,395,476 lekë – 7,373,684 lekë (vlera maksimale sipas observacionit) është efekt negativ financiar për buxhetin e shoqërisë (trajtuar më hollësisht në faqen 35-37 të Raportit Përfundimtar).

1.1. Rekomandimi:

Dega teknike apo strukturat e ngritura nga titullari i Autoritetit Kontraktor për përlllogaritjen e fondit limit, të marrë masa që në të ardhmen, përlllogaritja e fondit limit të bëhet vetëm mbi bazën e kostos totale të llogaritshme kur kostoja e llogaritshme e sistemeve teknike nuk e kalon vlerën 15% të kostos totale të projektit dhe me tarifa të ndara për sistemet teknike, kur kosto e tyre e tejkalon 15% të vlerën projektit.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi u konstatua se Shoqëria "I." shpk dhe Porti Detar sha Vlorë, kanë lidhur kontratën me nr. 450 Prot, datë 01.06.2017, për vendosjen e 16 m² reklama brenda territorit të Portit Detar Vlorë. Në kushtet e kontratës është vendosur periudha kohore prej 7 muajsh, çmimi 5,000 lekë/m² në vit dhe detyrimi i shoqërisë I shpk për pagesën paraprake të qirasë.

Nga përlllogaritja e bërë në zbatim të kontratës së sipërshënuar, rezulton se shoqëria "I." shpk duhet të kryente paraprakisht pagesën prej 16 m² x 5,000 lekë/m² në vit për 7 muaj = 46,667 lekë. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur, rezulton se në vendimin nr. 18, datë 27.07.2016 të Këshillit Mbikëqyrës të Portit Detar SHA Vlorë, tarifa e reklamës së thjeshtë dhe promocionit është 5,000 lekë/m² në muaj dhe nga rilllogaritja tarifa e paguar duhet të ishte 16 m² x 5,000 lekë/m² në muaj x 7 muaj = 560,000 lekë. Shoqëria "I." shpk ka paguar 42,500 lekë, ose **517,500 lekë** më pak se detyrimet sipas tarifave të miratuara, vlerë kjo **që është efekt financiar negativ për shoqërinë** (trajtuar më hollësisht në faqen 147-155 të Raportit Përfundimtar).

2.1 Rekomandimi:

Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë të shqyrtojë vlerën **517,500 lekë**, vlerë e cila ka të bëjë me vendosjen e tarifës së reklamave në mospërputhje me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës, si dhe të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, për arsye se kjo vlerë përbën efekt financiar negativ për Shoqërinë "Porti Detar" SHA Vlorë.

Brenda datës **31.05.2018**

3. Gjetje nga auditimi:

Me Vendimin nr. 13, datë 03.05.2015, Këshilli Mbikëqyrës vendosi kompensimin e pagesës për mos kryerjen e lejes së zakonshme të titullarëve të shoqërisë për z. Xh.Ç. në vlerën 101,794 lekë dhe znj. J. H. në vlerën 81,576 lekë. Vendimi i mësipërm është në kundërshtim me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, neni 93, pika 3 dhe VKM nr. 511, datë 24.10.2002 "Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore", i ndryshuar, Kreu II "Pushimet", pika 3, e cila përcakton se: "3. Pushimet vjetore nuk mund të kompensohen me pagesë, përveç rastit kur është zgjidhur marrëdhënia e punës. Çdo marrëveshje që parashikon heqjen dorë nga e drejta për pushim vjetor, kundrejt pagesës, do të jetë e pavlefshme". Duke qenë se marrëdhëniet e punës janë zgjidhur për z. Xh. Ç. më datpagesë 26.06.2015 dhe për znj. J. H. më datë 21.07.2017, e për pasojë pagesa duhej të kryhej në datën e shkëputjes së marrëdhënieve të punës dhe jo në këtë kohë. Për sa më sipër, kryerja e pagesës së lejes **në vlerën 183,370 lekë, përbën efekt financiar negativ** për llogari të shoqërisë Porti Detar SHA Vlorë (trajtuar më hollësisht në faqen 17-22 të Raportit Përfundimtar).

3.1 Rekomandimi:

Nga Drejtori i Shoqërisë të merren masat për kryerjen e një planifikimi të saktë të lejeve vjetore të punonjësve, duke marrë parasysh dhe proceset e punës së shoqërisë, me qëllim shmangien praktikave të tilla në të ardhmen.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi:

Në zbatim të Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr. 8, datë 04.04.2017, Drejtori i shoqërisë z. A.M., me Urdhrin nr. 113, datë 26.04.2017 “Mbi rritjen e nivelit të pagës bazë të punonjësve të “Porti Detar” Vlorë SHA”, ka vendosur që efektet financiare të rritjes së pagave me fuqi prapavepruese, edhe pse e pa miratuar nga Ministri, të fillojnë nga data 1 Shkurt 2017. Ky urdhër i drejtori të shoqërisë, është nxjerrë në tejkalim të kompetencave të tij ligjore, për arsye se, është në kundërshtim me Ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 6, pika 1, si dhe me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 8, datë 04.04.2017. Nga ky ndryshim me fuqi prapavepruese, ka ndikuar në rritjen e detyrimeve për paga për muajt Shkurt dhe Mars 2017, **në vlerën 880,410 lekë, vlerë e cila përbën efekt financiar negativ** për llogari të shoqërisë (*trajtuar më hollësisht në faqen 17-22 të Raportit Përfundimtar*).

4.1 Rekomandimi:

Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë të shqyrtojë vlerën **880,140 lekë**, vlerë e cila ka të bëjë me rritjen e nivelit të pagave nga Drejtori i shoqërisë me vendim me fuqi prapavepruese, si dhe të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, për arsye se kjo vlerë përbën efekt financiar negativ për Shoqërinë “Porti Detar” SHA Vlorë.

Brenda datës 31.05.2018

C. MASA ADMINISTRATIVE

Mbështetur në Ligjin Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7 dhe neni 15, pika 1 dhe 4, i rekomandoj Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit:

1. Të vendosë gjobën 100,000 lekë për shoqërinë “I. D”shpk, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektin “Zgjerimi i terminalit të pasagjerëve në Portin Detar Vlorë”, pasi:

- Ka certifikuar zërin e punimeve “Konstruksione metalike të përbëra”, në sasinë 115.7 ton x 310,000 lekë/ton = 35,867,000 lekë, të parealizuar në vepër, në kundërshtim me pikën 17 të Udhëzimit të KM Nr.3 datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve”, i ndryshuar dhe pikën 8, kreu II “Zbatimi i punimeve të ndërtimit”, të UKM nr. 2, datë 13.05.2005, “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”;

- Nuk ka marrë masa për ndjekjen e grafikut të punimeve në objektin “Zgjerimi i terminalit të pasagjerëve në Portin Detar Vlorë”, pasi punimet janë pezulluar pa dokumentacionin e kërkuar në legjislacionin e punimeve të ndërtimit.

2. Të vendosë gjobën 50,000 lekë për shoqërinë “A.” shpk, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektin “Rikonstruksioni i portës hyrëse perëndimore të portit”, pasi ka certifikuar punime të pakryera në vlerën 180,777 lekë, në favor të sipërmarrësit të punimeve “S.”shpk. **3.**

Të vendosë gjobën 50,000 lekë për shoqërinë “K. C.” shpk, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektin “Rikonstruksion i objektit të zyrave Porti Himarë”, pasi ka certifikuar punime të pakryera në vlerën 525,972 lekë, në favor të sipërmarrësit të punimeve “E.” shpk.

D. MASA DISIPLINORE

D.1. *Mbështetur në nenin 37 të “Kodit të Punës” si dhe nenit 5 të Kontratës “Për administrimin dhe drejtimin e shoqërisë Porti Detar sha Vlorë”, lidhur ndërmjet Këshillit Mbikëqyrës “Porti*

Detar sha Vlorë” dhe Drejtorisë së Portit Detar sha Vlorë, i kërkojmë Këshillit Mbikëqyrës së Portit Detar Vlorë, të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore nga “Vërejtje me shkrim” deri në “Largim nga detyra”, për personat si më poshtë:

1. A. M. me detyrë Drejtor i shoqërisë Porti Detar sha Vlorë, pasi:

- në cilësinë e titullarit të shoqërisë Porti Detar sha Vlorë, në objektin “Zgjerimi i terminalit të pasagjerëve në Portin Detar Vlorë” ka certifikuar zërin e punimeve “Konstruksione metalike të përbëra”, në sasinë 115.7 ton x 310,000 lekë/ton = 35,867,000 lekë, i parealizuar në vepër, në kundërshtim me pikën 17 të Udhëzimit të KM Nr.3 datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve”, i ndryshuar dhe pikën 8, kreu II “Zbatimi i punimeve të ndërtimit”, të UKM nr. 2, datë 13.05.2005, “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”;

- Nuk ka marrë masa për ndjekjen e grafikut të punimeve në objektin “Zgjerimi i terminalit të pasagjerëve në Portin Detar Vlorë”;

- Nuk është vënë në funksionim Ligji për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, nuk njihet nga strukturat drejtuese të shoqërisë e punonjësit e saj, nuk ka funksionuar në asnjë hallkë të njesisë dhe për pasojë, drejtuesit nuk kanë bërë një vlerësim të efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit

- Ka miratuar amendamentin e kontratës për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve në objektin “Krijimi i rrjetit data të institucionit të sigurt dhe të mbrojtur nga sulmet e jashtme, telefonia VOIP dhe sistemi i komunikimit email të institucionit”, në mënyrë të paargumentuar, duke krijuar të ardhura të munguara në Buxhetin e shoqërisë, për shkak të mosllogaritjes së penaliteteve kontraktuale.

- Me Urdhrin nr. 113, datë 26.04.2017 “Mbi rritjen e nivelit të pagës bazë të punonjësve të “Porti Detar” Vlorë SHA”, ka vendosur që efektet financiare të rritjes së pagave me fuqi prapavepruese, edhe pse e pa miratuar nga Ministri, të fillojnë nga data 1 Shkurt 2017 duke ndikuar në rritjen e detyrimeve për paga për muajt Shkurt dhe Mars 2017, në vlerën 880,410 lekë, vlerë e cila përbën efekt financiar negativ për llogari të shoqërisë;

- Në cilësinë e titullarit të AK, ka miratuar kriteret në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, në procedurat e prokurimit “Zgjerimi i terminalit të pasagjerëve në Portin Detar Vlorë”, “Mikëqyrja e punimeve në objektin zgjerimi i terminalit të pasagjerëve në Portin Detar Vlorë” dhe “Krijimi i rrjetit data të institucionit të sigurt dhe të mbrojtur nga sulmet e jashtme, telefonia VOIP dhe sistemi i komunikimit email të institucionit”

(Trajtuar më hollësisht në faqet 133 -143 dhe 163-165 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

D.2. Mbështetur në nenin 37 të “Kodit të Punës” si dhe Kontratës Individuale të Punës, lidhur ndërmjet Drejtorisë së Portit Detar sha Vlorë dhe punonjësve, i kërkojmë Drejtorit të Drejtorisë së Portit Detar Vlorë z. A.M., të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore nga “Vërejtje me shkrim” deri në “Largim nga detyra”, për personat si më poshtë:

2. F. Xh. me detyrë përgjegjës i Sektorit Juridik dhe Prokurimeve, pasi:

-në cilësinë e përgjegjës të Sektorit Juridik dhe Prokurimeve ka hartuar amendamentin e kontratës për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve në objektin “Krijimi i rrjetit data të institucionit të sigurt dhe të mbrojtur nga sulmet e jashtme, telefonia VOIP dhe sistemi i komunikimit email të institucionit”, në mënyrë të paargumentuar, duke krijuar të ardhura të munguara në Buxhetin e shoqërisë, për shkak të mosllogaritjes së penaliteteve kontraktuale;

-Në cilësinë e përgjegjësit të Sektorit Juridik dhe Prokurimeve dhe anëtarit të Njësisë së Prokurimit, ka lejuar të fillojnë procedurat e prokurimeve në shtatë objekte, të cilat nuk kanë marrë lejen e ndërtimit.

-Në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Prokurimit, ka lejuar fillimin e procedurave të prokurimit për “Blerje karburanti”, jo sipas nevojave për vitin ushtrimor.

- Në cilësinë e anëtarit të NJP, nuk ka përcaktuar KVK në tenderët “Rikonstruksioni i objektit të zyrave Himarë”, “Rikonstruksioni i zyrave dhe reparteve në ofiçinë”, “Linja e re e furnizimit me ujë të portit”.

- Në cilësinë e personit që hedh të dhënat në SPE, për shtesat e bëra në KVK në procedurat e prokurimit “Zgjerimi i terminalit të pasagjerëve në Portin Detar Vlorë” dhe “Hartimi i projektit për zgjerimin e terminalit të pasagjerëve në Portin Detar Vlorë”

3. E. Ç., me detyrë Kryetare e Degës Teknike, pasi:

- Në cilësinë e kryetares së KVO-së në procedurën e prokurimit “Zgjerimi i terminalit të pasagjerëve në Portin Detar Vlorë”, ka kualifikuar operatorin ekonomik fitues pa plotësuar kriteret e vendosura në DT;

- Në cilësinë e kryetares së KVO-së në procedurën e prokurimit “Mbikëqyrja e punimeve në objektin zgjerimi i terminalit të pasagjerëve në Portin Detar Vlorë”, ka kualifikuar 4 OE pjesëmarrës pa plotësuar kriteret e vendosura në DT dhe nuk ka kërkuar sqarime për ofertën anomalisht të ulët;

- Në cilësinë e kryetares së KVO-së në procedurën e prokurimit “Krijimi i rrjetit data të institucionit të sigurt dhe të mbrojtur nga sulmet e jashtme, telefonia VOIP dhe sistemi i komunikimit email të institucionit”, ka kualifikuar operatorin ekonomik fitues pa plotësuar kriteret e vendosura në DT;

- Në cilësinë e anëtares së KVO-së në procedurën e prokurimit “Veshje me alukobond dhe vendosje kioske në portën lindore të portit”, ka kualifikuar operatorin ekonomik fitues pa plotësuar kriteret e vendosura në DT;

4. I. H., me detyrë specialist i Degës Teknike, pasi:

- Në cilësinë e anëtarit të KVO-së në procedurën e prokurimit “Zgjerimi i terminalit të pasagjerëve në Portin Detar Vlorë”, ka kualifikuar operatorin ekonomik fitues pa plotësuar kriteret e vendosura në DT;

- Në cilësinë e anëtarit të komisionit për hartimin e KVK në procedurën e prokurimit “Mbikëqyrja e punimeve në objektin zgjerimi i terminalit të pasagjerëve në Portin Detar Vlorë”, ka vendosur kritere në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014“Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”;

- Në cilësinë e anëtarit të komisionit për hartimin e KVK në procedurën e prokurimit “Krijimi i rrjetit data të institucionit të sigurt dhe të mbrojtur nga sulmet e jashtme, telefonia VOIP dhe sistemi i komunikimit email të institucionit”, ka vendosur kritere në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014“Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”;

5. M. B. me detyrë specialiste e Prokurimeve, pasi:

Në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Prokurimit, ka lejuar të fillojnë procedurat e prokurimeve në shtatë objekte, të cilat nuk kanë marrë lejen e ndërtimit.

-Në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Prokurimit, ka lejuar fillimin e procedurave të prokurimit për “Blerje karburanti”, jo sipas nevojave për vitin ushtrimor.

6. M. P., me detyrë specialist në Degën Teknike, pasi:

-Në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Prokurimit, ka lejuar fillimin e procedurave të prokurimit për “Blerje karburanti”, jo sipas nevojave për vitin ushtrimor.

7. N. G., me detyrë zv/Drejtor i shoqërisë Porti Detar sha Vlorë, pasi

- në cilësinë e ish përgjegjësit të sektorit të marketingut, pasi ka lidhur kontrata për “truall të lirë” me sipërfaqe më të vogël se 200 m², në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për dhënie me qera ose enfiteozë të pasurive shtetërore”, i ndryshuar

8. D. B., me detyrë specialist në sektorin e marketingut dhe

9. D. M., me detyrë llogaritar i parë, pasi:

- në cilësinë e anëtarit të KVO-së në procedurën e prokurimit “Krijimi i rrjetit data të institucionit të sigurt dhe të mbrojtur nga sulmet e jashtme, telefonia VOIP dhe sistemi i komunikimit email të institucionit”, ka kualifikuar operatorin ekonomik fitues pa plotësuar kriteret e vendosura në DT;

- në cilësinë e anëtarit të KVO-së në procedurën e prokurimit “Zgjerimi i terminalit të pasagjerëve në Portin Detar Vlorë”, ka kualifikuar operatorin ekonomik fitues pa plotësuar kriteret e vendosura në DT;

10. A. Xh., me detyrë elektrikist, pasi:

- Në cilësinë e anëtarit të komisionit për hartimin e KVK në procedurën e prokurimit “Zgjerimi i terminalit të pasagjerëve në Portin Detar Vlorë”, ka vendosur kriteret në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”;

- Në cilësinë e anëtarit të komisionit për hartimin e KVK në procedurën e prokurimit “Mikëqyrja e punimeve në objektin zgjerimi i terminalit të pasagjerëve në Portin Detar Vlorë”, ka vendosur kriteret në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”;

11. A. B., me detyrë Specialiste kontratash dhe vlerësim risku, jurist, pasi:

- në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave në procedurën e prokurimit “Hartimi i projekt-preventivit të zbatimit për zgjerimin e terminalit të pasagjerëve në Portin Detar sha Vlorë”, ka bërë vlerësim subjektiv të ofertave teknike të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, duke ndryshuar fituesin e përcaktuar nga KVO, me vlerë 95,500 lekë më të ulët.

12. L. Rr., me detyrë specialist IT, pasi:

- Në cilësinë e anëtarit të komisionit për hartimin e KVK në procedurën e prokurimit “Krijimi i rrjetit data të institucionit të sigurt dhe të mbrojtur nga sulmet e jashtme, telefonia VOIP dhe sistemi i komunikimit email të institucionit”, ka vendosur kriteret në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”;

13. D. R., me detyrë specialiste, pasi:

- Në cilësinë e anëtarit të NJP, nuk ka bërë argumentimin e KVK në procedurat e prokurimit “Rikonstruksioni i objektit të zyrave Himarë”, “Rikonstruksioni i zyrave dhe reparteve në oficinë”, “Linja e re e furnizimit me ujë të portit”.

E. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR

Për nëpunësit e larguar z. T.N., znj. A.B., znj. D.Xh., znj. L. Xh. dhe znj. J. H. do të propozonim masën disiplinore “*Vërejtje me shkrim*” deri në “*Largim nga detyra*”, e cila quhet e ezauruar, pasi nëpunësit e mësipërm janë larguar nga detyra.

Gjithashtu do të kishim propozuar masë edhe për ekspertët e jashtëm z. A.B. dhe Gj.C. në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave për procedurën e prokurimit “Hartimi i projekt-preventivit të zbatimit për zgjerimin e terminalit të pasagjerëve në Portin Detar sha Vlorë” dhe z. F.Xh. në cilësinë e anëtarit të Komisionit për hartimin e KVK, në procedurën e

prokurimit me objekt “Zgjerimi i terminalit të pasagjerëve në Portin Detar Vlorë”, për të cilët mungon adresimi institucional.

F. TË TJERA

1. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i pasqyrave financiare u konstatua se:

Në bazat për opinionin e dhënë nga audituesit e pasqyrave financiare, në raportin e auditimit dhe letrën për drejtimin e shoqërisë, konstatohet se audituesit e pasqyrave financiare, nuk kanë kryer auditim për zbatimin e ligjshmërisë dhe përputhshmërisë në përputhje me Standardin Ndërkombëtar të Auditimit (SNA) 250 “Mbajtja parasysh e ligjeve dhe rregullave në një auditim të pasqyrave financiare”. Në raportin e auditimit të sipërcituar, nuk gjejnë vend rezerva në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së transaksioneve dhe llogarive që përbëjnë këto pasqyra financiare, çka nënkupton se auditimi nuk është kryer plotësisht në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA), në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 4, pika 3 (*trajtuar më hollësisht në faqen 25-29 të Raportit Përfundimtar*).

1.1 Rekomandimi:

Nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike të merren masa që të analizohet në kohë puna audituese e ekspertit kontabël të aprovuar në shoqërinë Porti Detar SHA Vlorë, në mënyrë që auditimi i pasqyrave financiare të kësaj shoqërie të kryhet në përputhje të plotë me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, me qëllim marrjen e sigurisë për përmbajtjen e pasqyrave financiare.

Në vijimësi

G. Departamenti Juridike, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, në vlerësim të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të analizojë dhe të konkludojë për ekzistencën ose jo të elementëve të figurës së veprës penale në vendosjen e kriterëve diskriminuesë në procedurat e prokurimit “Zgjerimi i terminalit të pasagjerëve në Portin Detar Vlorë”, “Mbikëqyrja e punimeve në objektin zgjerimi i terminalit të pasagjerëve në Portin Detar Vlorë” dhe “Krijimi i rrjetit data të institucionit të sigurt dhe të mbrojtur nga sulmet e jashtme, telefonia VOIP dhe sistemi i komunikimit email të institucionit”, për të përcjellë më pas në organet e Prokurorisë materialet përkatëse në formën e kallëzimit penal apo indicies penale.

Në vijimësi

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike.

Bujar LESKAJ

KRYETAR